

VENDIM
Nr. 387, datë 12.6.2019

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 216, DATË 20.4.2018, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E KRITERIT TË NOTËS MESATARE
PËR PRANIMIN E KANDIDATËVE NË PROGRAMET E STUDIMEVE TË
CIKLIT TË PARË DHE NË PROGRAMET E INTEGRUARA TË STUDIMEVE TË
CIKLIT TË DYTË OSE TRANSFERIMIN E STUDIMEVE NË VITET E
NDËRMJETME TË KËTYRE PROGRAMEVE, NË INSTITUCIONET E ARSIMIT
TË LARTË, PËR VITIN AKADEMIK 2018–2019”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 74, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Numrat rendorë 14 dhe 15, të tabelës në shtojcën 1, të vendimit nr. 216, datë 20.4.2018, të Këshillit të Ministrave, për programet e studimit të ciklit të parë “Pedagogji Muzikore” dhe “Pikturë Grafike”, në universitetin “Luigj Gurakuqi”, Shkodër, për vitin akademik 2018–2019, shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe